

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Uashingtoni zbuloi armët në orbitë, Kina kërkon çmilitarizimin e hapësirës
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/uashingtoni-zbuloi-armet-ne-orbite-kina-kerkon-cmilitarizimin-e-hapesires/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:34:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:30:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d6f1ee56e08f75fe76fd7ecd077dd7733ca12aea15187ae789d32c4c0f5f989f
TEKSTI	b53db6c123cf83bbba7a279daf4c40a999446ed2d10fec238e488c305fa1eebd
PAMJA	ef5e42312557c0488af76fde996beb733114c4fd0b0c915b290bb8e4c86fc53a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	db0b145c0211e2ea215290970d94db9b71ee00d14bb078aacf6d1779909ccc9d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/db0b145c0211e2ea215290970d94db9b71ee00d14bb078aacf6d1779909ccc9d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > BOTA

Uashingtoni zbuloi armët në orbitë, Kina kërkon çmilitarizimin e hapësirës

16:30 : 16/09/2026 në BOTA



Shtetet e Bashkuara kanë deklaruar se kanë vendosur tashmë në orbitë sisteme të afta për të mbrojtur forcat amerikane nga kërcënimet në hapësirë. Njoftimi ka shkaktuar reagime të menjëhershme nga Kina dhe Rusia.

Sekretari i Forcave Ajrore amerikane, Troy Meink, gjatë një konference të hënën tha se SHBA-të janë të përgatitura për t'iu përgjigjur kërcënimeve të reja, pavarësisht se ku shfaqen.

"Ju garantoj se jemi të gatshëm të përballemi me kërcënimet në zhvillim, kudo që ndodhen. Për këtë arsye, Shtetet e Bashkuara kanë vendosur tashmë në orbitë armë për kontrollin e hapësirës, të afta të mbrojnë forcat tona të përbashkëta nga veprimet armiqësore", deklaroi Meink.

Ai nuk dha detaje mbi llojin e këtyre sistemeve, mënyrën e vendosjes së tyre apo kohën kur janë dërguar në orbitë. Për këtë arsye, mbetet e paqartë se çfarë lloj teknologjie ushtarake bëhet fjalë.

Deklaratat amerikane kanë sjellë reagim nga Pekini. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze, Guo Jiakun, u bëri thirrje Shteteve të Bashkuara të ndalojnë zgjerimin e kapaciteteve ushtarake në hapësirë.

Lexo edhe:

["E respektojmë aktgjykimin"/ SHBA reagon pas vendimit të Hagës: Të shmangjet retorika nxitëse](#)["Gjuetarë satelitesh", "rrëmbyes robotesh" dhe "bllokime lazeresh"! Armët që SHBA ka vendosur në orbitë](#)

"Kërkojmë që Shtetet e Bashkuara të ndalojnë zgjerimin e kapaciteteve ushtarake dhe përgatitjet për luftë në hapësirë", tha Guo.

Edhe Moska reagoi përmes zëdhënësit të Kremlinit, Dmitri Peskov, i cili deklaroi se Rusia pret mbështetje ndërkombëtare për çmilitarizimin e plotë të hapësirës.

TË GJITHA



Uashingtoni zbuloi armët në orbitë, Kina kërkon çmilitarizimin e hapësirës

16:30 : 16/09/2026



Dënimi në Hagë/ Thyhen xhamat e bazës së EULEX-it, bllokohet rruga Prishtinë-Fushë Kosovë

16:16 : 16/09/2026



PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë

16:05 : 16/09/2026



Besmir Beja i Doganave rrit taksën e zhdoganimit të makinave me urdhër të brendshëm

15:59 : 16/09/2026



"E respektojmë aktgjykimin"/ SHBA reagon pas vendimit të Hagës: Të shmangjet retorika nxitëse

15:52 : 16/09/2026



Hetimet ndaj Ballukut, paraqiten në SPAK vëllezërit Alban dhe Olsi Eftimi

15:43 : 16/09/2026



"O Olta o hajdute"/ Pas Ballukut, qytetarët i 'zënë pritë' në rrugë edhe Xhaqës (Video)

15:40 : 16/09/2026

Debati për përdorimin ushtarak të hapësirës nuk është i ri. Në vitin 1967 hyri në fuqi Traktati për Hapësirën e Jashtme, i cili ndalon vendosjen në orbitë të armëve bërthamore. Megjithatë, traktati nuk ndalon në mënyrë të përgjithshme sistemet konvencionale ushtarake në hapësirë.

Me zhvillimin e teknologjisë satelitore dhe përdorimin e inteligjencës artificiale, SHBA, Rusia dhe Kina kanë investuar gjithnjë e më shumë në kapacitete që mund të përdoren për qëllime ushtarake. Në vitin 2018, gjatë mandatit të tij të parë, Donald Trump njoftoi krijimin e Space Command. Një vit më vonë u krijua edhe US Space Force, si një strukturë e veçantë e ushtrisë amerikane.

Një pjesë e projekteve të zhvilluara nga SHBA-të mbeten sekrete. Sipas Bledwyn Bowen, profesor i Astropolitikës në Durham University, nuk ka shumë gjasa që sistemet e vendosura në orbitë të jenë platforma që mund të lëshojnë raketa. Ai vlerëson se mund të bëhet fjalë për pajisje të luftës elektronike, të afta për të ndërhyrë në funksionimin e satelitëve kundërshtarë.

Megjithatë, ekspertët nuk e përjashtojnë mundësinë që kapacitetet amerikane të jenë më të avancuara. Deklarata e Meink se sistemet synojnë të “mbrojnë forcat e përbashkëta” ka lënë të hapur pyetjen se cilat janë konkretisht këto armë dhe çfarë aftësish kanë.

Etiketa: kina SHBA

Lajme të lidhura



“E respektojmë aktgjykimin”/ SHBA reagon pas vendimit të Hagës: Të shmanget retorika nxitëse

15:52 : 16/09/2026



“Gjuetarë satelitësh”, “rrëmbyes robotësh” dhe “bllokime lazerësh”! Armët që SHBA ka vendosur në orbitë

10:10 : 16/09/2026



FBI zbulon planin rus për vrasje në SHBA dhe Europë

09:58 : 16/09/2026



Lufta me Iranin i kushtoi SHBA-së 33.4 miliardë dollarë

17:39 : 15/09/2026



Zgjedhjet dhe vonesat institucionale në Kosovë “pengojnë agjendën” me SHBA-në

12:58 : 15/09/2026



Trump kundër ngadalësimit të ritmit të AI: Ide kineze, SHBA duhet të ruajë epërsinë

11:45 : 15/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

